



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prodato Received/Delivery	20.12.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAVISHK	7582/2023		112



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.915/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen juridike administrative sipas ankesës me numër A.nr.915/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit/
Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, me bazë juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.915/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje referuar: Ankuesi), me datë 05.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5027/2023 të regjistruar nën shenjën A.nr.915/2023 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit, gjegjësisht Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, lidhur me refuzimin e kërkesës për njohjen e të drejtës në pushim vjetor, sikurse përcaktohej me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa me datë 20.12.2023 i njëjti ka parashtruar kërkesë përmes emailit zyrtar, me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.915/2023 të datës 05.07.2023, me arsyetimin se objekti për të cilën ishte parashtruar ankesa tani më është përmbushur nga organi përkatës i punësimit- Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.915/2023 të datës 05.07.2023, pasi që nga kërkesa e datës 20.12.2023 rezulton se ankuesi nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative, ngase objekti për të cilën ishte parashtruar ankesa është përmbushur nga organi përkatës i punësimit, dhe si rrjedhojë i njëjti e ka tërhequr ankesën me numër A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.915/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

